



**BASHKIA DIBËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

**VENDIM NR 89 Datë 30.06.2020**

“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015** “ Për vetqeverisjen vendore”, **Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016** “ Për Prefektin e Qarkut “, **Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019** “ Për Mbrojtjen Civile”, **VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012** “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” **kreu III, pika 1, gërma ë**, dhe Vendimit **nr. 76 prot datë 02. 08. 2017, pika I**, Këshilli Bashkisë, në mbledhjen e tij, datë **30.06.2020 miratoi me 15 vota pro,4 vota kundër,1 votë apstenim.**

**VENDOSI :**

- I. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
- II. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi 2 kat** në pronësi të **z. Halil Dedja** njësia administrative Tomin ( fshati Dohoshisht ) në shumën totale **133208** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **133208** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **ska**.
- III. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **66604** lekë ( 50 % të vlerës totale të dëmit ) për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.

Kryetar Këshilli

Sokol SAVA

